



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Në bazë të nenit 67 dhe 68 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 90/2010), Udhëzimit administrativ nr. 02/2018 për Qendrat Burimore, Rregullores (QRK) nr. 05/2022 për procedurat konkurruese dhe pranimi për nëpunësit administrativ dhe mbështetës, MASHTI, shpall:

KONKURS

Për vendet e lira të punës në Qendrat Burimore

Nr.	Pozita	Vendi i lirë/zëvendësim	Nr. i pozitave
1	<i>Servuese në QB “Nënë Tereza” në Prizren</i>	Kohë të pacaktuar	1
2	<i>Shtëpiak në QB “Lef Nosi” në Prizren</i>	Kohë të pacaktuar	1
3	<i>Roje nate në QB “Përparimi” në Prishtinë</i>	Kohë të pacaktuar	1

I . Punët dhe detyrat e servuesit/es

- E bën servimin e ushqimit në sallën e ushqimit (mëngjesit, drekës dhe darkës);
- Është përgjegjës për pastërtinë e hapësirës së kuzhinës;
- Pastron inventarin në hapësirën e kuzhinës;
- Bën hedhjen mbeturinave të kuzhinës në deponi të caktuar të qendrës;
- Pastron enët dhe pajisjet tjera të ushqimit;
- Kryen dhe punë tjera që i cakton drejtori.

1. Përgatitja shkollore për servues/e në kuzhinë

- Arsimi i mesëm.

II. Punët dhe detyrat kryesore të punës për shtëpiak

- Kujdeset për meremetime të ndryshme në objektin e shkollës;
- Bën riparimin e dyerve, dritareve, dyshemesë, inventarit në Qendër Burimore dhe konvikt, si dhe në hapësirat përcjellëse të Qendrës Burimore;
- Mirëmban ngrohjen qendrore dhe kujdeset për funksionimin e saj (në kohën kur aktivizohet ngrohja qendrore duhet të dal dy orë më herët në punë për të bërë ndezjen e ngrohjes);
- Është përgjegjës për punëtorinë e shkollës;
- Mban evidence dhe raporton te drejtori i QB për riparimet e bëra
- Kryen edhe punë tjera që i cakton drejtori (sipas nevojës mund te caktohet orari i punës dy pjesësh).

2. Përgatitja shkollore për shtëpiak

- Arsimi i mesëm.

III. Punët dhe detyrat kryesore të punës për roje nate

- Ruan dhe kujdeset për sigurinë e hapësirës së Qendrës Burimore;
- Kontrollon hyrjet dhe daljet në objektin e Qendrës Burimore dhe mban evidence;
- Gjatë orarit të punës i kontrollon të gjitha hapësirat e Qendrës Burimore dhe bën evidentimin e të gjitha parregullsive në librin e kujdestarisë;
- Gjatë orarit të punës kujdeset që në hapësirat e jashtme dhe të brendshme të objektit të QB të mos ndodhë zjarr, vërshime apo vjedhje;
- Në rast të fatkeqësive të ndryshme ofron ndihmë për nxënësit e QB;
- Kryen edhe punë tjera që i cakton drejtori i QB.

3. Përgatitja shkollore për roje nate

- Arsimi i mesëm.

Kushtet e konkursit

Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente.

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHTI.

Përparësi në konkurs kanë kandidatët që ofrojnë diploma/certifikata për aftësi profesionale që korrespondojnë me vendin e punës që cilin konkurrojnë.

Në intervistë me shkrim ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit.
Kandidatët që aplikojnë duhet të jenë banor të Republikës së Kosovës.
Koeficienti për servuese 3.86.
Koeficienti për shtëpiak dhe roje 3.76.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.
Formulari i aplikimit (merret në Qendrën Burimore ku është konkursi).
Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë).
Diploma e kualifikimit dhe duhet të jenë të noterizuar.
Kandidatët, dokumentet duhet ti dorëzojnë në Qendrën Burimore përkatëse ku konkurrojnë.
Aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen.